



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 08.10.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me numër protokolli: MOQREM- 0057, për zyrtaren Saxhide Sadiku, Zyrtare për Zhvillim të Zonave Ekonomike në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pasi që e njëjta në cilësinë e anëtares së Komisionit Vlerësues ka marrë pjesë në vendimmarrje për vlerësimin e ofertave për tenderin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”, e caktuar sipas Vendimit Ref.12 Nr.84, i datës 20.08.2024, ku si fitues është rekomanduar grupi i operatorëve ekonomik: Kema – Company SH.P.K.; K.N.P.KSH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.; ALFA.i.; N.N.P. ATC COM SH.P.K., ku si Lider i këtij grupi është operatori ekonomik i cili njëkohësisht ka qenë punëdhënës i zyrtares Saxhide Sadiku dhe i bashkëshortit të saj D.S., duke rënë ndesh kështu me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, lidhur me nenin 17, nenin 6, dhe nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, nenit 24, paragrafi 6, lidhur me nenin 19, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, dhe paragrafi 4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kërkon nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë:
 - a) Anulimin e Kontratës me titull: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”, me numër të Prokurimit: MINT204-24-6755-5-1-1, datë: 15.11.2024, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe
 - b) Inicimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtares Saxhide Sadiku, për shkeljet e dispozitave të nenit 24 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
- III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës

penale e procedon rastin në prokurorinë kompetente, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;

IV. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe të njëjtit bëhen publik në faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtaren Saxhide Sadiku, Zyrtare për Zhvillim të Zonave Ekonomike në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (në vijim: KIESA) - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (në vijim: MINT), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimi të raportimit nga jashtë (MOQREM- 0057) me pretendimet se *(citojmë nga kërkesa e denoncuesit): “[...] Me datën 20.08.2024 është formuar komisioni për vlerësimin e tenderit „Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas,, me numër te prokurimit 204-24-6755-5-1-1 (e nxjerr nga platforma eprokurimi). Lidhur me këtë proces në komision të vlerësimit është caktuar personi i angazhuar me kontratë ne vepër (kontratë me shërbime te veçanta) Saxhide Sadiku. Komisioni vlerësues ka shpallur fitues kompaninë „Kema Company sh.p.k., ne vlere 7,755,554.00 euro. Kompania e cila është shpallur fituese dhe është kontraktua, ne këtë tender milionësh, ka te punësuar burrin e saj (te Saxhides) zotin D.S qe nga viti 2021 e deri me rastin e vlerësimit ne vitin 2024. Znj. Sadiku ne këtë rast ka krijuar konflikt direkt te interesit, ku punën prej rreth 8 milion euro ja ka dhen kompanisë ku punon burri i saj [...]”*.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përmes shkresës zyrtare DPKI-06-556/25, e ka njoftuar zyrtaren Saxhide Sadiku për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Sipas procedurës janë marrë edhe veprime tjera, ku është realizuar një takim me zyrtaren Saxhide Sadiku në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku janë diskutuar dhe shtjelluar faktet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë. Në takim, zyrtarja në fjalë ka deklaruar se pretendimet e prezantuara janë të pavërteta dhe asnjëra nga to nuk qëndrojnë, duke deklaruar se asnjëherë nuk ka pasur përfitime financiare nga OE “Kema Company”, ndërsa CV-ia me të cilën ka aplikuar si OE në MINT ka qenë e mëhershme dhe e pa përditësuar. Tutje, e njëjta ka shtuar se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ajo nuk ka deklaruar asnjë konflikt interesi, sepse në atë kohë bashkëshorti i saj D.S nuk ka qenë pjesë e kompanisë “Kema Company”.

Pas takimit të mbajtur në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, zyrtarja Saxhide Sadiku ka dërguar përmes emailit informacione, sqarime shtesë ku ka deklaruar se: *“Duke u bazuar në CV-në me të cilën kam aplikuar si Zyrtare Publike ju bashkëngjisë në attach ku dëshmohet se Operatori Ekonomik “Kema Company” nuk figuron si kompani që kam punuar, sepse nga kjo kompani asnjëherë nuk kam pasur përfitime financiare e as marrëveshje për ekzekutim të ndonjë projekti, andaj edhe nuk është paraqit në CV, gjithashtu vlen të theksohet se edhe*

gjendja nga Trusti dëshmon se unë asnjëherë nuk kam pasur përfitime financiare nga ky operator ekonomik. Cv për të cilën është bërë ankesa ka qenë e pa përditësuar dhe arsyen e figurimit të kësaj kompanie aty ju kam sqaruar gojarisht në takim dhe është Cv kur kam aplikuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si Operator ekonomik ku edhe kur kam pranuar vendimin për komisionin për të cilin jam denoncuar kam qenë duke punuar si OE dhe jo si zyrtare publike. Gjithashtu e shoh të arsyeshme të ju shkruaj në lidhje me disa sqarime eventuale në lidhje me të dhënat e dokumentacionit të dorëzuar për bashkëshortin si në vijim: Gjendja e trustit për bashkëshortin: Në këtë dokumentacion paraqiten vetëm kontributet të cilat janë të paguara dhe jo kontributet të cilat janë të deklaruar andaj mendoj se gjendja më e saktë dhe më reale në lidhje me përfitimet financiare dëshmon gjendja bankare e nxjerr nga banka për periudhën 01.01.2023-30.04.2025. Gjendja bankare për bashkëshortin dëshmon pranimin e pagave për periudhat në të cilat ka punuar ku siç shihet se nga data: 03.12.2022 bashkëshorti ka qenë në Gjermani dhe deri në periudhën e muajit korrik 2023 nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me operatorin ekonomik Kema Company [...]”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, për të vërtetuar pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, sipas procedurës për hetim administrativ, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga KIESA - MINT përmes shkresës DPKI-560/25, dhe të njëjtat i ka pranuar përmes postës elektronike si dhe përmes CD-së.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të informacioneve dhe dokumentacionit të bashkangjitur nga raportuesit e rastit, sqarimeve të zyrtares Saxhide Sadiku dhënë në takimin e mbajtur në Agjenci, dokumentacionit plotësues të siguruar nga KIESA - MINT, rezulton gjendja faktike si në vijim:

Me datë 03.10.2023, Udhëheqësi i Sektorit për Zhvillimin e ZE, ka adresuar tek Divizioni i Prokurimit-MINT, kërkesën për angazhimin e një zyrtari/inxhinieri i diplomuar i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, drejtimi Konstruktiv ose Infrastrukturë, Bachelor i Ndërtimtarisë. Në këtë kërkesë është cekur se: “Pasi që jemi në fillim të këtij viti dhe pritet të ketë një rritje të dinamikës së punës, ku jemi në përmbyllje të disa projekteve kapitale, [...] përfshirë “Parkun Industrial Drenas 2”, kërkojmë nga ju që të zhvillonit procedurat e prokurimit e prokurimit publik të kontraktimit për 6 muaj angazhimin për KIESA me orar të plotë, me mundësi vazhdimi të kontratës, të një zyrtari shtesë / një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, drejtimi Konstruktiv ose Infrastrukturë, Bachelor i Ndërtimtarisë, pasi që me kapacitetet aktuale të angazhuar në kuadër të sektorit të zonave ekonomike nuk mund t’i përmbylim të gjitha aktivitetet e planifikuara në planin e punës.”;

Me datë 17.10.2023, MINT ka publikuar Njoftimin për Kontratë me titull: “Angazhimi i një inxhinieri në KIESA”;

Me datë 08.11.2023, Autoriteti Kontraktues MINT, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, në të cilin thuhet se: “Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë- **shpërblen me kontratë ofertuesin "Saxhide Sadiku"**;

Nga dokumentacioni i siguruar përmes kërkesës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit nga MINT, është vërejtur se në dosjen me të cilën ka ofertuar Saxhide Sadiku në aktivitetin e prokurimit me titull: “Angazhimi i një inxhinieri në KIESA”, në CV-në prezantuar në këtë

dosje si punëdhënës i saj figuron “Kema Company” SH.P.K., nga viti 2018 e tutje, po ashtu në këtë dosje është bashkëngjitur edhe një ‘Letër Rekomandimi’, i datës: 05.09.2023, për Saxhide Sadiku, e lëshuar nga OE “Kema Company” SH.P.K me përmbajtjen si në vijim: *“Znj. Sadiku ka punuar në kompaninë tonë në nivelin Bachelor i ndërtimtarisë që nga viti 2018 dhe ende vazhdon të kontribuoj në po këtë nivel si bashkëpunëtorë e jashtme. Gjatë punës znj. Sadiku ka treguar profesionalizëm dhe disiplinë, gjithashtu kontributi i saj ka qenë dhe vazhdon të jetë në pjesën e udhëheqjes dhe menagjimit të punimeve në infrastrukturë të ulët respektivisht në Rikonstruimin e rrugëve: “Rr. Haxhi Zeka”- Prishtinë dhe “Rr. Ahmet Krasniqi”- Prishtinë;*

Autoriteti Kontraktues MINT, më datë 24.11.2023, ka nënshkruar Kontratën me titull: “Angazhimi i një Inxhinieri në KIESA”, me numër identifikues: MINT204-23-11273-2-3-6, me Ofruesin e Shërbimeve Saxhide Sadiku në kohëzgjatje prej 6 muaj me mundësi vazhdimi edhe 6 muaj të tjerë;

Me datë 20.05.2024, drejtori i DZIHSP N.B, ka adresuar tek zyra e Prokurimit kërkesën për vazhdimin e kontratës edhe për 6 muaj të tjerë për ing. Saxhide Sadiku, referuar profesionalizimit dhe bashkëpunimit gjatë kohës 6 mujore që ka treguar Saxhide Sadiku me projektet me të cilat ka qenë e angazhuar;

Me pas autoriteti kontraktues MINT, ka bërë vazhdimin e kontratës me titull: “Angazhimi i një inxhinieri në KIESA” edhe për 6 muaj të tjerë;

Më datë 04.07.2024, Autoriteti Kontraktues MINT, në portalin E- prokurimi ka publikuar Njoftimin për Kontratë me titull: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2- Parku i Përgjithshëm në Drenas”;*

Zyrtari i prokurimit B.K., përmes emalit të datës 14.08.2024, ka adresuar tek u.d. Drejtori i Përgjithshëm i KIESA, Z.D., kërkesën për emërimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për tenderin me titull: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”*. Më pas, kërkesës së zyrës së prokurimit, Z.D. i është përgjigjur me datë 19.08.2025, duke adresuar përbërjen e komisionit vlerësues në përbërje prej tre zyrtarëve e në mesin e tyre edhe Saxhide Sadiku si dhe M.S.;

Me datë 20.08.2024, MINT- KIESA ka nxjerrë vendimin me nr.: Ref.12 Nr.84, me të cilin formohet komisioni vlerësues për shqyrtimin e ofertave për tenderin: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”*, në përbërje prej tre anëtarëve, si anëtarë e tretë është edhe Saxhide Sadiku;

Komisioni për vlerësimin e tenderit me titull: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”*, më datë 02.10.2024, ka nxjerr Raportin e Vlerësimit të Tenderëve me rekomandimin si në vijim: *‘Meqë kriter bazë për shpalljen e fituesit është Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët , ku në bazë të rangimit oferta e përgjegjshme është Grupi o Operatorëve Ekonomik Kema- Company SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.; ALFA.i; N.N.P. ATC COM SH.P.K. Komisioni vlerësues rekomandon këtë ndërmarrje për kontratë: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2- Parku i Përgjithshëm në Drenas, i cili rekomandim ka mare aprovimin edhe nga zyrtari i prokurimit’;*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të lëndës që posedon Agjencia, rezulton se në dosjen e operatorit ekonomik fitues është përfshirë **Marrëveshja për themelimin e grupit – Konsorciumit**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”*, në të cilën marrëveshje **“Kema Company”** SH.P.K është përcaktuar si **lider i grupit**;

Kështu, më datë 24.11.2024, MINT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka nënshkruar kontratën me titull: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”*, me Grupin e Operatorëve Ekonomik **“Kema- Company”** SH SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPIENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.; ALFA.i; N.N.P. ATC COM SH.P.K.;

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar informatën zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës, se: *“[...] D.S ka qenë i punësuar tek biznesi “Kema Kompany” SH.P.K me NUI 810382309, prej periudhës 01/2024 deri 07/2024 si dhe në vitin 2025 prej periudhës 01/2025 deri më 05/2025”*.

Çështja e afërsisë familjare ndërmjet Saxhide Sadiku dhe D.S (i punësuar në **“Kema Company”**), është vërtetuar edhe nga Agjencia e Regjistrimit Civil, e cila në përgjigjen e saj drejtuar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (DPKI-1939/25) ka konfirmuar se: *‘bazuar në të dhënat nga Regjistri Civil, ku si bazë për verifikimin kemi përdorur statusin martesor të të dy shtetasve Saxhide Sadiku dhe D.S., rezulton se lidhja familjare mes tyre është “bashkëshort”*;

Andaj pas vlerësimit dhe administrimit të provave në dispozicion, kemi ardhur në përfundim se:

I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me numër: MOQREM- 0057, për zyrtaren Saxhide Sadiku, Zyrtare për Zhvillim të Zonave Ekonomike në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pasi që në cilësinë e anëtares së Komisionit Vlerësues, e njëjta nuk ka deklaruar dhe ka marrë pjesë në vendimmarrje e caktuar sipas Vendimit Ref.12 Nr.84, i datës 20.08.2024, me rastin e vlerësimit të ofertave për tenderin: *“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas”*, ku si fitues është rekomanduar grupi i operatorëve ekonomik: **Kema – Company** SH.P.K.; K.N.P.KSH. PAPIENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.; ALFA.i; N.N.P. ATC COM SH.P.K., ku si Lider i këtij grupi është operatori ekonomik i cili njëkohësisht ka qenë punëdhënës i zyrtares Saxhide Sadiku dhe i bashkëshortit të saj D.S., duke rënë ndesh kështu me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, lidhur nenin 17, nenin 6, dhe nenin 3, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Sipas dispozitës së nenit 9, paragrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përcaktuar se:

“Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:

1.8 të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit”.

Ndërsa sipas nenit 17, paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje”,

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përkufizuar me nenin 6 nocionin e konfliktit të interesit, si në vijim:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Po ashtu sipas Nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik¹ konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."

si dhe nën-paragrafin 1.12 të këtij neni, i cili definon nocionin e vendimmarrjes si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik".

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të në një çështje të caktuar.

Në rastin konkret, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar se ekziston konflikti i interesit për faktin se zyrtarja Saxhide Sadiku në cilësinë e anëtares së Komisionit Vlerësues e caktuar sipas Vendimit Ref.12 Nr.84, të datës 20.08.2024, ka marrë pjesë në

¹ Person juridik - subjekti juridik i vendit apo i huaj, i cili sipas legjislacionit të Kosovës në fuqi konsiderohet si person juridik (Neni 113, paragrafi 6 i Kodit Nr. 06/l-074 Penal të Republikës së Kosovës);

vendimmarrje me rastin e vlerësimit të ofertave për tenderin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2- Parku i Përgjithshëm në Drenas”, ku si fitues është rekomanduar dhe përzgjedhur Operatori Ekonomik me të cilin zyrtarja Saxhide Sadiku si dhe bashkëshorti i saj kanë pasur marrëdhënie afariste (raporte kontraktuale) në pesë (5) vitet e fundit, konkretisht OE Kema Company S.H.P.K., rezulton të ketë qenë punëdhënës i zyrtares Saxhide Sadiku (nga viti 2018, e tutje sipas Letër Rekomandimit të lëshuar më datë 05.09.2023 nga OE Kema Company) dhe gjithashtu punëdhënës i bashkëshortit të saj D.S. deri në muajin Maj të vitit 2025, duke kështu rënë ndesh me nenin 9 paragrafin 1, nën paragrafin 1.8., të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Për më tepër, edhe legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik, ka përcaktuar në mënyrë të qartë rregullimin e situatave që lidhen me konfliktin e interesit gjatë procedurave të prokurimit publik. Në këtë drejtim me nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.75 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092), nocioni i Konfliktit të Interesit është përkufizuar si në vijim: “*çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues, të cilët janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose që mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure, kanë drejtpërdrejt ose tërthorazi një interes personal, financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet si komprometues i paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit*”.

Po ashtu, neni 39, paragrafi 13 i Rregullores Nr.002/2024 për Plotësim dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, përcakton se:

“në rast se një anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstaton se ai/ajo ka një konflikt interesi në vlerësimin e tenderit, ai/ajo është i/e obliguar të deklarojë interesin e tij/saj dhe të largohet nga takimi, duke mos marrë më pjesë në procesin e vlerësimit lidhur me aktivitetin në fjalë, ndërsa mbetet i obliguar për ruajtjen e konfidencialitetit”.

Dispozitat e sipërcituara të legjislacionit për prokurim publik nënvizojnë detyrimin ligjor të zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit për shmangien e çdo situatë që krijon ose që mund të perceptohet se krijon konflikt interesi, si dhe garantojnë paanshmërinë, transparencën dhe integritetin e procedurës së prokurimit publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, mbështetur në dispozitat e nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit [Përgjegjësitë e Agjencisë], si dhe nenit 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit [Fushëveprimi], nuk është lëshuar në trajtimin e pretendimeve tjera të ngritura nga raportuesi i rastit, të cilat pretendime nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht janë jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

II. a). Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kërkon anulimin Kontratës me titull: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku u Përgjithshëm në Drenas”, me numër të Prokurimit: MINT204-24-6755-5-1-1, e datës 15.11.2024, konform nenit 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili ka përcaktuar se;

“Agjencia inicion veprimet ligjore në institucionet kompetente, me qëllim shpalljen e pavlefshmërisë dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj për aktet dhe kontratat administrative të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, me kërkesën e palëve të interesuara ose me nismën e saj”.

dhe nenin 24 paragrafi 6, me të cilin është përcaktuar se:

“Agjencia inicion procedurën administrative dhe/ose gjyqësore për anulimin e akteve dhe për obligimin e zyrtarit përgjegjës për shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit.”

II. b). Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit gjithashtu kërkon iniciimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtares Saxhide Sadiku, për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe atë sipas nenin 24, paragrafi 1, të këtij ligji, me të cilin është përcaktuar se:

*“Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësi eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me rregullat që i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe statusin e zyrtarëve. Institucionet/organizatat që i kanë iniciuar procedurat disiplinore sipas këtij ligji **duhet ta njoftojnë Agjencinë për iniciimin dhe rezultatin e atyre procedurave.**”*

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale e procedon rastin në prokurorinë kompetente, në pajtim me nenin 24, paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

“Agjencia, çdo zyrtar, udhëheqës i zyrtarit dhe çdo institucion ushtrojnë kallëzim penal në prokurorinë e shtetit kompetente ndaj zyrtarit i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës”,

...lidhur me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku përcaktohet se:

Agjencia është përgjegjëse për: “Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent”.

VI. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: *Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Ministres së MINT dhe ZKA-së
- Zyrtares Saxhide Sadiku (palëve procedurale)
- Drejtorit të DPKI- së
- Bartësit të lëndës

Yll Buloshtaj
Drejtore i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

